REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 306/20
Datë/Datum. 18.05.20
PRISHTINË - PRIŠTINA

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **KOMUNA SUHAREKË**

Për Aktivitetin e Prokurimit:

Nr. i prokurimit	**624-18-060-511 & 624-18-5071-5-1-1**

Sa i përket tenderit për: **Projektimi dhe Ndërtimi i impiantit të mbeturinave rricikluese**

ANKESË

1.Identifikimi i ankuesit*

ALFA.I SH.P.K

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Rr. Ibrahim Rugova pn.

(Adresa)

Lipjan — *14 000*

(Vendi) — *(Kodi postar)*

00383 38 606 706 — *N/A*

(Numri Telefonit) — *(Numri i Faks-it)*

Lulzim JAHAJ

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

info@alfa-i.com

(Adresa elektronike)

15.05.2020

(Data e parashtrimit të ankesës)

Limited Liability Company alfa.i Trade

(Nënshkrimi dhe vula)

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

_____

(Emri i avokatit)

_____

(Adresa e plotë)

_____ _____

(Numri i Telefonit) *(Numri i faks-it)*

_____

(Adresa elektronike)

_____ _____

(Data e parashtrimit të ankesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës", "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Njoftimi për Kontratë: 16.07.2018 Data e hapjes së ofertave: 27.08.2018 Njoftimi mbi vendimin e AK:27.04.2020 Kërkesa për rishqyrtim dt. 04.05.2020

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐ **Jo** ☒

Limited Liability Company
alfa.i
Construction · Engineering & Trade

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po [X] **Jo** [ ]

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po [X] **Jo** [ ]

Kemi bërë kërkesë për rishqyrtim, ndërsa nuk kemi pranuar vendim-përgjigje në kërkesën tonë për rishqyrtim.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 1 i LPP-së **Neni 7 i LPP-së** **Neni 9 i LPP-së** **Neni 59 i LPP-së** **Neni 62 i LPP-së** **Neni 108/A i LPP-së** **Neni 44.5 i RRUOPP-së**

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë te rrejshme ose mashtruese.*

Limited Liability Company
alfa.i
Construction Engineering & Trade

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Të nderuar ne kemi pranuar njoftimin mbi vendimin e AK-së me dt. 27.04.2020, ku e ka anuluar aktivitetin e prokurimit me arsyetimit se "*Komuna Suharekë me datë 10.04.2020 ka pranuar shkresë (e-mail) nga Sekretari i Ministrisë së Infrastrukturës, ku na sqaron lidhur me projektin Ndërtimi i impiantit të mbeturinave ricikluese në Suharekë, se Qeveria e Kosovës gjatë planifikimit të buxhetit me Qarkoren e dytë buxhetore këtë projekt e ka hequr nga linjat buxhetore, dhe se ky projekt nuk është paraparë në buxhetin e vitit 2020".*

Si fillim po ua rikujtojmë se AK-ja ka nxjerr disa vendime të ndryshme dhe kundërthënëse që nga fillimi i vlerësimit të parë.

Në vendimin e datës: 10.10.2018 është rekomanduar për kontratë TEHNIX D.O.O.
Në vendimin e datës: 21.01.2019 është anuluar aktiviteti i prokurimit.
Në vendimin e datës: 18.04.2019 është rekomanduar për kontratë VGP DRAVA Ptuj.
Në vendimin e datës: 28.08.2019 është rekomanduar për kontratë TEHNIX D.O.O.
Në vendimin e datës: 29.11.2019 jemi rekomanduar ne (Alfa.i),
Në vendimin e datës: 20.02.2020 është anuluar përsëri aktiviteti i prokurimit.

Ndërsa tani përsëri e kanë anuluar këtë aktivitet të prokurimit por me arsye tjera kinse në mungesë të buxhetit.

Fillimisht ju sqarojmë se ne si OE i përgjegjshëm po diskriminohemi në këtë aktivitet të prokurimit për shkak të zhagitjeve të vlerësimeve dhe rivlerësimeve nga ana e AK-së sepse nëse rishikohen kërkesat për rishqyrtim, ankesat njoftimet mbi vendimet e AK-së të mëhershme, shihet qartë dhe kuptohet se vetëm ne jemi ofertues i përgjegjshëm duke i plotësuar të gjitha kërkesat e FDT-së dhe të njoftimit për kontratë.

Vendimin e AK-së për anulimin e këtij aktiviteti të prokurimit, ne e shohim vetëm pretekst për të mos na shpallur neve si fitues të këtij tenderi sepse dihet që AK-ja e ka stërzgjatur së tepërmi këtë aktivitet të prokurimit edhe pse ne kemi qenë të përgjegjshëm autoriteti kontraktues ka vazhduar duke na diskriminuar neve, sepse tri herë i ka rekomanduar për kontratë OE tjerë të papërgjegjshëm gjithashtu edhe e ka anuluar aktivitetin e prokurimit edhe dy herë të tjera, pa ndonjë arsye konkrete dhe ligjore vetëm që ne si OE i përgjegjshëm të heqim dorë nga ky aktivitet i prokurimit, ndërsa neve na ka shpallur fitues një herë.

Përderisa Autoriteti kontraktues fillimisht ka nënshkruar Deklaratë të Nevojave dhe Disponueshmërisë së Fondeve" sipas nenit 9 të LPP-së dhe konform kësaj dispozite ka përcaktuar edhe llojin dhe përmasat e sakta të nevojave të veçanta të Komunës së Suharekës, që prokurimi i propozuar parasheh t'i plotësojë, prandaj pavarësisht mjeteve eventuale që nuk janë parashikuar për Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit hapësinor, AK-ja duhet të vazhdojë procedurën dhe mjetet ndërkohë mund të sigurohen apo të sigurohen në faza të ndryshme-me rishikim të buxhetit apo në vitet tjera, sepse ne si operator ekonomik nuk duhet të pësojmë shkaku i këtyre rrethanave, e të cilat rrethana mund të vijnë si pasojë e neglizhencave apo qëllimeve eventuale të ndonjë zyrtari institucional.

Limited Liability Company
alfa.i
Construction - Engineering & Trade

Gjithashtu dispozitat e nenit 8 të RRUOPP-së shkruan qartë "Deklarata e nevojave dhe përcaktimi i disponueshmërisë së fondeve", shkruan qartë si në vijim: "*AK do të inicioi një aktivitet të prokurimit vetëm pasi që të ketë kryer një vlerësim formal të nevojave, pse saktësisht nevojitet prokurimi. Qëllimi i vlerësimit paraprak të nevojave bëhet që të sigurohet që bëhen vetëm prokurime të sakta dhe të nevojshme, dhe të evitohet prokurimi jo-efikas si dhe te sigurohet qe lendet qe i përmbushin këto nevoja nuk janë ne dispozicion nga ndonjë autoritet tjetër publik*".
Pra përderisa ky aktivitet i prokurimit ka të bëjë me Projektimin dhe Ndërtimin e impiantit të mbeturinave ricikluese dhe dihet saktësisht se çfarë rëndësie ka ky projekt për qytetarët, atëherë është e pabesueshme që ky projekt te mos shpallet përsëri (e mjetet gjinden pastaj), mirëpo në këtë rast po dëmtohemi ne si operator ekonomik i përgjegjshëm sepse po na mohohet nënshkrimi i kësaj kontrate.

Deri më tani ne nuk kemi pranuar përgjigje mbi refuzimin/aprovimin e kërkesës tonë për rishqyrtim nga ana e autoritetit kontraktues. Ndërsa AK-ja me dt.08.05.2020 e ka publikuar njoftimin për anulimin e aktivitetit të prokurimit në mënyrë kundërligjore, sepse ne kemi parashtruar kërkesë për rishqyrtim dhe nuk na ka kthyer përgjigje duke mos respektuar nenin 108/A të LPP-së dhe duke qenë të detyruar që të mbetet i pezulluar aktiviteti i prokurimit deri në një vendim tjetër të AK-së, e ka anuluar këtë aktivitet të prokurimit.
AK-ja nuk ju ka përmbajtur afatit për shqyrtim të ankesës, i cili është maksimalisht 6 ditë, ndërsa pastaj fillon të rrjedh afati ligjor për parashtrim të ankesës në OSHP edhe 10 ditë tjera, gjë që tregon më së miri arbitraritetin e Komunës dhe vazhdimin e diskriminimin tonë si OE i përgjegjshëm në këtë aktivitet të prokurimit.

Prandaj kërkojmë fillimisht nga OSHP-ja që të ndërhyjë dhe ta detyrojë autoritetin kontraktues që të anulojë anulimin e aktivitetit të prokurimit, pasi që me këtë veprim ka vepruar arbitrarisht dhe ka paragjykuar rezultatin final të ankesës në OSHP.

Ne me dt.14.05.2020 kemi kërkuar një sqarim edhe nga KRPP-Help Desk-u i tyre në lidhje me kërkesën tonë se mos ka pasur ndonjë problem, ndërsa me dt.15.05.2020 kemi pranuar përgjigje nga KRPP-ja ku sqaron se kërkesa për rishqyrtim është bërë me dt.04.05.2020 në prokurim, e që kuptohet që ka qenë brenda afatit ligjor pasi që njoftimin mbi vendimin e kemi pranuar me dt.27.04.2020, ndërsa dita e pestë i ka rënë ditë e shtunë, ditë vikendi, kurse ne e kemi parashtruar kërkesën për rishqyrtim të hënën me dt.04.05.2020.

Pra KRPP ka sqaruar se kërkesa për rishqyrtim është pranuar me dt.04.05.2020 dhe AK-së i ka shkuar njoftimi-notifikimi dhe natyrisht prej atij momenti AK-ja ka mundur ta shkarkon kërkesën për rishqyrtim.
Bashkangjitur keni komunikimin tonë me KRPP.

Duke u bazuar në të gjitha sqarimet që i kemi cekur më lartë, rezulton se anulimi i këtij aktiviteti të prokurimit është bërë në kundërshtim me nenin 62 të LPP-së dhe në kundërshtim me nenin 44.5 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurim Publik, sepse asnjëra nga kushtet e parashikuara në këto dispozita nuk janë përmbushur.

Gjithashtu AK-ja nuk e ka respektuar edhe nenin 7 i LPP-së, duke na diskriminuar neve si operator ekonomik, edhe pse i kemi plotësuar të gjitha kërkesat e FTD-së dhe të njoftimit për kontratë, nuk jemi shpallur fitues të këtij tenderi.

Gjithashtu autoriteti kontraktues nuk i ka respektuar edhe dispozitat e nenit 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe

Limited Liability Company alfa.i

më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë. Duke u bazuar në dëshmitë dhe argumentet që u cekën më lartë, kërkojmë nga OSHP, që të merr: **VENDIM** **APROVOHET,** si e bazuar ankesa e OE ***"ALFA.I SH.P.K"*** **ANULOHET,** njoftimi dhe vendimi i AK-së për anulim të aktivitetit të prokurimit dhe lënda kthehet në **RIVLERËSIM** dhe gjatë rivlerësimit, ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i ofertave të bëhet në harmoni me kërkesat e dosjes së tenderit, njoftimit për kontratë dhe konform dispozitave të LPP-së. Nëse nuk merren parasysh faktet tona, ne jemi të detyruar të vazhdojmë procedurën ligjore institucionet tjera kompetente.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Neve si Operator Ekonomik na janë bërë dëme materiale për përgatitjen dhe dorëzimin e ofertës, për kërkesën për rishqyrtim në vlerë prej 5,000.00 euro.

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni kërkesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
b) një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".
c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet.

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*

Limited Liability Company alfa.i Construction - Engineering & Trade